



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**



KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE PËR PËRJASHTIME  
Raport i përmbledhur i procesit të Takimit Publik  
Datë: 22.03.2026

**RAPORT I TAKIMIT PUBLIK PËR PËRJASHTIME NGA KUSHTET NDËRTIMORE**

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110, në pajtim me dispozitave e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, si dhe në harmoni me nenin 37 të Udhëzimit Administrativ MMPH – NR.24/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, Komisioni për Përrjashtimet i formuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës me numër 01 Nr.112/02-1087 datë 09.01.2025, ka organizuar **TAKIM PUBLIK** për elaborimin e aplikimeve të palëve për përjashtim nga Kushtet ndërtimore të përcaktuar me Hartë Zonale.

Komisioni për Përrjashtimet mbi kërkesat për Kushte ndërtimore /Leje ndërtimore, sipas kërkesave të parashtruara për përjashtime nga Kushtet e Ndërtimit ka organizuar Takim Dëgjimorë Publik për të njëjtat me datë 13.03.2026, duke e publikuar informatën për mbajtjen e takimit që nga data 06.03.2025 ( Faqja e përgjithshme: Dokumenti: [https://gjakova.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/1\\_2\\_merged.pdf](https://gjakova.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/1_2_merged.pdf) ).

Aplikimi i trajtuar dhe të publikuar me përjashtimet e mundshme është:

- Aplikimi me numër 07-351/02-35136 datë 08.07.2025 Zona jug lindore e Komunës së Gjakovës – zona përgjatë rrugës tranzite ish “ Tirana “, parcela kadastrale ( pjesë ) me numër P-70705028-05077-2 Z.K. Gjakovë jashtë qytet., aplikuesi Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për ngritjen e objektit “SHTËPI PËR MBROJTJEN DHE EDUKIMIN E FËMIJËVE;

Komisioni për trajtimin e kërkesave për Përrjashtime nga Kushtet e ndërtimit të përcaktuara me dokumentin e Planifikimit Hapësinor – Harta Zonale e Komunës së Gjakovës 2024-2032, para publikimit të Njoftimit ka trajtuar aplikimin në veçanti sipas kërkesës së parashtruar dhe të trajtuar nga ana e bartësit të lëndës. Për aplikim -rastin e trajtimit është hartuar përjashtimi i mundshëm bazuar në kërkesat dhe parakushtet e terrenit me gjendje fizike të objekteve të rrethinës tanimë të krijuar / formësuar, shfrytëzimin aktual dhe të realizuar bazuar në dokumentin paraprak të planifikimit hapësinorë “Planit Rregullues Urban Tirana” ku e njëjta është kompleks i objekteve banimore shumë banesore të banimit social dhe të njëjtat i ka publikuar përmes Njoftimit Publik për Takim publik.

Në Takimin dëgjimor Publik ka marrë pjesë Komisioni dhe Zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ndërsa nga ana e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - përgjegjëse e Projektit, apo ndonjë grupi tjetër të interesit nuk morën pjesë.



PËRJASHTIMI I REFEEROHET APLIKIMIT TË VIJËS SË NDËRTIMIT NË DISTANCË  
D=6.0M' NGA VIJA RREGULLATIVE ;

**Rekomandim:** Të lejohen Kushtet e ndërtimit sipas analizës, prezantimit në Takim dëgjimorë, Prezantimit grafik të lokacionit dhe parametrave të objektit për ndërtim, sipas arsyeshmërisë teknike dhe funksionale të argumentuar dhe aplikimit të vijës ndërtimore përgjatë rrugës qasëse në distancë D=6.0m'.

Bashkangjitur me Raport :


- Vendimin me numër 01 Nr.112/02-1087 datë 09.01.2025 për formimin e Komisionit për përjashtime;
- Njoftimin e hapjes së Takimit Publik me informatë për Dëgjim Publik;
- Proces verbal-in nga Takimi dëgjimorë publik;

Komisioni për përjashtime:

1.Elida Bejtullahu, inxh.dip.ark. ( Kryesuese)

2.Durrije Berisha inxh.dip.ark. ( Anëtare )

3.Florent Koci ( Anëtarë )



The image shows three handwritten signatures in blue ink, each written over a horizontal line. The first signature is the most prominent and appears to be 'Elida Bejtullahu'. The second signature is smaller and appears to be 'Durrije Berisha'. The third signature is also smaller and appears to be 'Florent Koci'.